

E DREJTA E FËMIJËVE PËR MBIJETESË DHE ZHVILLIM

Koncepti i të drejts së fëmijës për JETË përmban në vete, përveç të drejtës për të mos u vrrarë, edhe të drejtën për të mbijetuar dhe të drejtën për zhvillim.

Shtetet-nënshkruese të KDF-së “sigurojnë mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës”.

Koncepti MBIJETESË përdoret në vend të konceptit RRITJE. Pra, koncepti mbijetesë është më dinamik, më i gjallë, se koncepti JETË.

Koncepti mbijetesë përfshin edhe veprimet parandaluese: kontrolli i sëmundjeve dhe imuniteti, ushqimi i gjirit dhe zhdukja e analfabetizmit të gratë, që lidhen me shëndetin e fëmijës.

Në konceptin mbijetesë përfshihet edhe mosdiskriminimi i fëmijëve në shërbimet mjekësore. “Asnjë fëmijë të mos jetë i privuar nga e drejta për të pasur shërbime mjekësore” (KDF).

Vetëkuptohet që kjo e drejtë garantohet edhe për fëmijët me nevoja të veçanta. Ata “duhet të gëzojnë një jetë të plotë dhe dinjitoze, në kushte që garantojnë lehtësimin e pjesëmarrjes së tyre aktive në bashkësi” (KDF).

Në përputhje me të drejtat e fëmijës për mbijetesë dhe zhvillimi, qeveritë duhet:

- të marrin masa për uljen e mortalitetit të foshnjave dhe fëmijëve,
- t’i japin përparësi rritjes së kujdesit për shëndetin e fëmijëve,
- të sigurojnë kushte për luftimin e sëmundjeve të fëmijëve,
- të sigurojnë produktet ushqimore dhe ujin e pijshëm,
- të sigurojnë kushtet e duhura për nënat, para dhe pas lindjes,
- të afirmojnë përparësitë e të ushqyerit me qumështin e gjirit,
- të afirmojnë rëndësinë e higjienës dhe të mjedisit të pastër,
- të afirmojnë përparësitë e të ushqyerit me qumështin e gjirit,
- të afirmojnë rëndësinë e higjienës dhe të mjedisit të pastër,

Shtetet-nënshkruese të KDF-së obligohen që të sigurojnë maksimumin e këtyre të drejtave të fëmijëve.

Zhvillimi normal dhe i plotë i fëmijës, nuk varet vetëm nga kujdesi i nënave, i familjes, i rrethit shoqëror dhe i shtetit, për fëmijët nga lindja e tyre e tutje, por edhe nga kujdesi për fëmijët para lindjes së tyre.

Pra, për të drejtat e **fëmijës ende të pa lindur**, mund të flitet njëlloj, sikurse edhe për të **drejtat e fëmijës së porsalindur**.

Për mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës para lindjes së tij, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, thekson **rëndësinë e kujdesit shëndetësor për nënat shtatzëna**.

Psikologët kanë vërtetuar se **ditët e para, javët dhe muajt e parë, pas lindjes së fëmijës, kanë rëndësi të madhe** për zhvillimin e ardhshëm, normal dhe të plotë, të tij.

Për këtë arsye, fëmija, pas lindjes, duhet të ketë mundësi **për t'u lidhur dhe për të komunikuar plotësisht me nënën dhe me të rriturit e tjerë**. Por:

1. A e dinë prindërit këtë fakt aq të rëndësishëm për fatin e fëmijëve të tyre?
2. A kanë ata mundësi të jenë gjithmonë me fëmijët e tyre?

Studimet kanë vërtetuar se:

- **kujdesi dhe edukimi prindor për shumë fëmijë nuk është në nivelin e duhur as në vendet e zhvilluara**, dhe
- Fëmijët e nënave **më të arsimuara kanë shanse më të mëdha për të mbijetuar**, se sa fëmijët e nënave më pak të arsimuara ose analfabete.

E drejta e fëmijës për mbijetesë dhe zhvillim, nuk kufizohet vetëm në të drejtën e zhvillimi fizik të fëmijës, por ajo përfshin **zhvillimin e plotë dhe harmonik** të fëmijës, pra edhe zhvillimin **mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror**.

Rrjedhimisht: e drejta e fëmijes për zhvillim përfshin edhe **kohën e lirë, kulturën dhe arsimimin-edukimin** e fëmijës.

- **Arsimi fillor** duhet të jetë **i detyrueshëm, i hapur dhe falas** për të gjithë fëmijët,
- **Arsimi i mesëm** duhet të jetë **i hapur dhe i mundshëm** për të gjithë fëmijët, në rast nevojë, duhet **të ndihmohet edhe financërisht**,
- **Në arsimin e lartë** duhet të kenë **mundësi të hyjnë të gjithë fëmijët, sipas aftësive të tyre** (KDF).

Qeveritë oblogohen të marrin masa për **zvogëlimin e braktisjes së shkollës** nga ana e fëmijëve. (Varfëria - shkaku i braktisjes së shkollës nga fëmijët në Kosovë).

Vëmendje të shtuar qeveritë duhet të kenë:

- për **shkollimin e vajzave**, dhe

- për **shkollimin në gjuhën amtare**, të fëmijëve të grupeve minoritare.

E drejtat e fëmijës për arsimim-edukim nuk ka të bëjë vetëm me qasjen në shkollë, por edhe me **cilësinë e arsimimit-edukimit**.

Arsimi-edukimi duhet:

- të zhvillojë **personalitetin e fëmijës, talentin dhe aftësitë e përgjithshme të tij**,
- të përgatis fëmijën për një **jetë të përgjegjshme, në një shoqëri të lirë, me frymën e mirëkuptimit, të paqes, të tolerancës, të barazisë gjinore dhe miqësisë ndërmjet njerëzve, etnive e feve**.

Studimet kanë vërtetuar se interesimi i fëmijëve për shkollë është **në rënie**, sepse:

- mësimdhënësit dhe leksionet e tyre janë **të merzitshme**,
- programet mësimore janë **të stërngarkuara**,
- mësohet shumë **teori** në shkolla, prandaj mësimet bëhen **të vështira**,
- qëndrimet e mësimdhënësve ndaj nxënësve **nuk janë të mira**,
- ka **dhunë fizike dhe psiqike** ndaj nxënësve.

Shtetet-nënshkruese të KDF-së, **favorizojnë dhe inkurajojnë** bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit-edukimit:

- për të kontribuar në zhdukjen e injorancës dhe analfabetizmit në botë,
- për të lehtësuar përvetësimin e njohurive shkencore dhe teknike,
- për të përvetësuar metodat moderne të arsimit-edukimit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushë të arsimit, ka marrë parasysh **nevojat e vendeve në zhvillim**.

Kështu, koncepti **ZHVILLIM** është interpretuar **në kuptimin më të gjerë, në kuptimin e gjallë** të tij.

Vetëkuptohet që të gjitha shtetet **nuk i kanë mundësitë ekonomike** për sigurimin e të drejtave të fëmijës, sipas KDF-së. Pra, **obligimet dhe mundësitë** e shteteve lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijës **qëndrojnë në shpërputhje**.

Sipas KDF-së, shtetet-nënshkruese të Konventës duhet t'i marrin masat:

- brenda të gjitha **mundësive dhe burimeve të tyre** dhe, kur është e nevojshme, edhe
 - brenda kuadrit të bashkëpunimit ndërkombëtar.
- për respektimin dhe sigurimin e të drejtave të fëmijës.

Kjo do të thotë:

- vendet e varfëra të plotësojnë **minimumin e detyrimeve të Konventës**, dhe
- vendet e pasura të japin **maksimumin e burimeve të tyre ekonomike**.

Shtetet duhet të hartojnë **strategji për të identifikuar dhe ndihmuar** fëmijët që janë në gjendje të pafavorshme, **në varfëri të skajshme**.

Në KDF nuk përmendet në mënyrë të qartë **çështja e abortit**, që, në ditët tona, është shndërruar në çështje debatesh dhe polemikash të ashpra - “për” dhe “kundër”.

Konventa, në frazën: **“fëmija ka nevojë për një mbrojtje dhe përkujdesje të veçantë ... si para, ashtu edhe pas lindjes”** ka shkaktuar një **konfuzion**, sepse mund të interpretohet si **“për”**, ashtu edhe **“kundër”** abortit.

Mesazhet për mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës janë **transmetuar në të katër anët e botës**. Janë **shpëtuar shumë jetë fëmijësh**, por **zhvillimi** i tyre nuk është siguruar.

Lufta për **shpëtimin e jetës** së fëmijës, duhet të vazhdojë me përpjekjet për të **siguruar zhvillimin** e tij.

Pra, çështja e **mbijetesës së fëmijës**, është e **lidhur ngusht** me çështjen e **zhvillimit** të tij.

PYETJET:

1. Koncepti “e drejta për jetë” përmban në vete:
 - a) vetëm të drejtën për të mos u vrarë,
 - b) edhe të drejtën për të mbijetuar dhe të drejtën për zhvillim.
2. Më dinamik, më i gjallë është koncepti:
 - a) jetë, apo
 - b) mbijetesë?

3. Të drejtat e fëmijëve në përgjithësi, garantohen edhe për fëmijët me nevoja të veçanta:

- a) Po,
- b) Jo.

4. Qeveritë-nënshkruese të KDF-së obligohen që të sigurojnë:

- a) minimumin e të drejtave të fëmijës,
- b) mesataren e të drejtave të fëmijës,
- c) maksimumin e të drejtave të fëmijës.

5. Të drejtat e fëmijës përfshijnë perudhën pas lindjes së tyre, por edhe para lindjes së tyre:

- a) Po,
- b) Jo.

6. Shanse më të mëdha për të mbijetuar kanë fëmijët e:

- a) nënave më të arsimuara,
- b) nënave më pak të arsimuara dhe analfabete.

7. Të drejtat e fëmijës për mbijetesë dhe zhvillim, përfshijnë të drejtën e zhvillimit:

- a)
- b)
- c)
- d)

8. Të drejta e fëmijës për zhvillim, përfshin edhe kohën e lirë, kulturën dhe arsimimin-edukimin e fëmijës.

- a) Po,
- b) Jo.

9. Shkollimi fillor duhet të jetë:

.....

Shkollimi i mesëm duhet të jetë:

.....

Shkollimi i lartë duhet të jetë:

.....

10.E drejta e fëmijës për arsimim-edukim, ka të bëjë:

- a) me qasjen në shkollë,
- b) edhe me cilësinë e arsimimit-edukimit.

11.Qeveritë duhet të kenë vëmendje të shtuar për shkollimin:

- a)
- b)

12.Interesimi i fëmijëve për shkollë është në rënie, sepse:

- a)
- b)
- c)
- d)

13.Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushë të arsimit, ka marrë parasysh:

- a) nevojat e shteteve në zhvillim,
- b) nevojat e shteteve të zhvilluara.